



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ**

---

Numri i lëndës: 2022:245934

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05440273

**E.nr.103/12**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit individual Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në lëndën përbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit M.S., me numër personal..., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 103.70 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 12.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDOHET** procedura përbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës - Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit M.S., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 103.70 euro (njëqind e tri euro e shtatëdhjetë cent).

**A r s y e t i m**

Gjykata me Aktvendimin E.nr.103/12 me dt.13.04.2012 e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala me seli në Prishtinë, ndaj debitorit M.S., nga fshati..., në shumën prej 103.70 euro.

Debitori me dt.11.03.2024 e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbushur borxhin në tërsi, kjo dëshmohet përmes dëftesave të lëshuara nga Telekomi i Kosovës nr.73141761 e dt.11.03.2024 e cila është në shumën prej 103.70 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me nr. të pagesës 19208819-2024-Skenderaj, e lëshuar nga Posta e Kosovës dt.11.03.2024.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**E.nr.103/12, me dt.12.03.2024**

**Gjyqtari**  
Hajrullah Aruqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.